



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 219/17 Prot.

Patos më 03.02.2026.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 30.01.2026

I mbajtur sot më datë 30.01.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Liljana Mesutaj
2. Lori Musaj
3. Artan Velçani
4. Armand Ahmetaj
5. Ertilla Myrtaj
6. Smerald Hazizaj
7. Elmira Rama
8. Renaldo Shpata
9. Vjollca Kasaj
10. Novrus Toska
11. Shezai Sinanaj
12. Adile Alushaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

I nderuar Kryetar

Jemi në mbledhjen e këshillit bashkiak

Pjesmarrja në mbledhje është 12 këshilltarë.

Mbledhja është thirrur në zbatim të rregullores, bazohet në nenin 53 pika 4 dhe 56 pika 2 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",

Jeni njohur me materialet të gjithë pasi ju është përcjell me email. Pasi kemi lexuar materialet e komisionit kryesisht komisioni i Ligjeve i cili ka pasur për detyrë shqyrtimin e pikës katër dhe nëntë të rendit të ditës. Nuk dua ta kaloj në votim para se ta them këtë nga ekzekutivi është kërkuar tërheqja nga shqyrtimi i pikës nëntë, besoj ma konfirmojnë anëtarët e komisionit të ligjeve pra rendin e ditës do ta lexoj pa pikën nëntë, e cila tërhiqet për një kohë me pas.

Kemi ndonjë kërkesë paraprakisht, ndonjë shtim të ndonjë pike tjetër apo ndonjë heqje?

Lexojmë rendin e ditës

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 17.12.2025.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 17.12.2025.
- 4- Projekt-vendim "Mbi kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%".
- 5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin dhjetor 2025".
- 6- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin dhjetor 2025".
- 7- Projekt-vendim "Mbi përdorimin e grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026".
- 8- Projekt-vendim "Për miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2026, nga fondet e trashëguara nga viti 2025".
- 9- Projekt-vendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 77, datë 27.11.2025, "Për miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Patos dhe Ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026".
- 10- Raport për dëgjuesat publike për vitin 2025.

Armand Ahmetaj- kush është dakord me miratimin e rendit e ditës?

Miratohet me 12 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Smerodol Hoxhaj

Artan Velcom

Lori Muxaj

Alide Alushaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 219/18 Prot.

Patos më 03.02.2026

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot më datë 30.01.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 17.12.2025

Armand Ahmetaj –Keni ndonjë verejtje, ndonjë kërkesë për korrigjimin e procesverbalit? Konsiderohet i ezauruar, miratohet dhe pika 2.

SEKRETARE  
Refaela Xeba

Smerold Hoxhi

Artan Velcam

Zori Musaj

Adile Alushaj

KRYETAR  
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 219 / Prot.  
19

Patos më 03 02.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.01.2026 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 17.12.2025

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 17.12.2025 u morën gjithsej 7 vendime nga nr. 79 deri ne 85.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime vendimi me nr. 81 dhe 82 i është përcjell Prefekturës dhe ka ardhur përgjigja se vendimet janë në përputhje me ligjin.

Gjithashu më lejoni t'ju bëj me dije se në datë 09.12.2025 patëm një kontroll në vend nga Prefektura ku objekti i kontrollit ishte verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve normative të organit përfaqësues dhe organit ekzekutiv të bashkisë Patos, për periudhën shtator-nentor 2025 si dhe Vendimet e kthyer nga Prefekti si vendime në kundërshtim me ligjin për periudhën objekt verifikimi.

Si përfundim

Për periudhën shtator-nentor 2025 nuk ka akte normative të padepozituara për verifikim ligjor nga Prefekti i Qarkut Fier.

Nuk ka akte të kthyer si në kundërshtim me ligjin,

Për periudhën shtator-nentor 2025 nuk ka akte të kundërshtuara për pavlefshmëri në gjykatë.

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 212 / Prot.  
13

Patos më 03 02.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.01.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Mbi kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”.

Armand Ahmetaj- Ja jap fjalën ekzekutivit .

Klaudio Alisinanaj është prezent në sallë, jemi 13 këshilltarë .

Mitjon Nikolla – relacion “Mbi kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” si dhe të ardhurat e bashkisë. Duke qënë se jemi në fillim të vitit po bëjmë rifreskim të kriterëve për të cilat nuk është së kemi ndryshim nga vitet e kaluara, themi nga viti 2021 e në vijim.

Spektori i Shërbimit Social parashikon si kriterë

Kriteret për tu perzgjedhur për tu trajtuar për fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar ose nga të ardhurat e bashkisë të cilat janë të njëjta janë këto:

Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda 3 muajve të fundit nëpërmjet regjistrat elektronik pra nëpërmjet sistemit për ndihmë ekonomike por nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit pra janë djegur për arsye të pikëve të pamjaftueshme. Të mos jenë refuzuar nga sistemi i pikëzimit për deklaratim të rremë, të paktën për 6 muajt e fundit të mos kenë bërë deklaratim të rremë ndryshe për 6 muaj këta janë në listën e kuqe dhe nuk mund të riaplikojnë.

Përparësi për përfitimin e ndihmes ekonomike do të kene kategoritë e mëposhtme:

- Kryefamiljare gra të veja me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
- Kryefamiljare gra të divorcuara me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë
- vajza nëna
- Persona në moshë madhore të mbetur vetëm në trungun familjar pas vdekjes së prindërve të tyre

- Familje në vështirësi të madhe ekonomike pa asnjë lloj të ardhure tjetër.

Për këto familje përparësi do të ketë gjendja social-ekonomike e përcaktuar nga formulari i vlerësimit social-ekonomik, i cili kryhet nga administratorët e bashkisë Patos ose të njëjsteve si dhe numri pjestarëve të secilës familje .

- Rastet kur kryefamiljari ose ndonjë antar madhor është i paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit në fuqi nuk përfiton pagesën e PAK.

Nuk përfitojnë ndihmë ekonomike familjet që edhe pse plotësojnë kushtet e mësipërme:

- a) U propozohet qoftë edhe njëherë punë dhe nuk pranojnë të punojnë.
- b) U propozohen kurse të formimit profesional dhe nuk pranojnë.
- c) Refuzojnë vlerësimin social-ekonomik në familje nga administratori shoqëror i ndihmës ekonomike pra nuk pranojnë të kryejnë formularin e vetdeklarimit.
- d) Fshehin informacione ose kryejnë deklaim të rremë.

Këto janë kriteret si për ndihmën 6% dhe për të ardhurat e bashkisë.

Klaudio Alisinanaj – Këtë projektvendim e shqyrtoj dhe komisioni i ligjeve i cili u mbledh në 28.1 dhe pas diskutimeve ramë dakord me propozimet që bëri ekzekutivi duke e miratuar me katër vota pro.

Armand Ahmetaj- prezente në sallë dhe këshilltarja znj. Albiona Lamaj

Armand Ahmetaj- Jeni të hapur për diskutime?


Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim “Mbi kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”.

Kush është dakord?

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 220/Prot.  
13

Patos më 03 02.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.01.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin dhjetor 2025”.

Mitjon Nikolla – projektvendim nr. 06 datë 20.01.2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin dhjetor 2025”.

Spektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Dhjetor 2025 gjithsej 18 familje me një fond prej 87,949 (tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzetë e nëntë) lekë.

Lori Musaj - Komisioni ekonomisë u mbledh para dy ditësh në datën 28 ka shqyrtuar mbi këtë projektvendim i cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin dhjetor 2025”.

Kush është dakord?

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Smerod Hoxha

Arban Velami

Lori Musaj

Adile Alushaj

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 221/3 Prot.

Patos më 03 02.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.01.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin dhjetor 2025”.

Mitjon Nikolla – Projektvendimi nr. 07 datë 20.01.2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin dhjetor 2025”.

Spektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Dhjetor 2025 gjithsej 14 familje me një fond prej 42,751 (dyzetë e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një) lekë.

Lori Musaj - Gjatë mbledhjes së komisionit kemi diskutuar dhe mbi këtë projektvendim i cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin dhjetor 2025”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE  
Refaela Xeba

Smerol Hoxha  
Artur Velami  
Cori Musaj  
Folite Alushi

KRYETAR  
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 213 / Prot.

Patos më 03.02.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.01.2026 në orën 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Mbi përdorimin e grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026”.

Boreta Murati- Projektvendim nr. 02 datë 20.01.2026, “Mbi përdorimin e grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026”.

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhmin Financiar dhe Kontrollin”, kreut VII-të të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKB nr. 82, datë 17/12/2025 “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetin e bashkisë Patos për vitin 2026”,

Në buxhetin e vitit 2025 është parashikuar objekti me emërtim “Ndërtimi i fushave të basketbollit në Njësitë Patos” në vlerën 10,574,029 (dhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëzet e nëntë) lekë, investim i cili nuk është realizuar në kohë për shkak të hartimit të projektit dhe si pasojë objekti nuk është prokuruar brenda vitit kalendarik 2025.

Kryetari Bashkisë- Për shkak të oponencës.

Boreta Murati- të gjithë faktorëve, oponencës teknike. Në përfundim të objektit që ne të jemi në përputhje me të gjitha kriteret e përcaktuara për ligjin e ndërtimit duhet që projekti të kalojë oponencën teknike të institucioneve përkatëse siç është instituti ndërtimit apo fakulteti i ndërtimit kështu që brenda vitit kalendarik nuk është përfunduar kjo procedurë në kohë për këtë arsye ne nuk e kemi prokuruar brenda vitit kalendarik 2025.

Projekti “Krijimi i parkut rekreativ në Lagjen e Re” ka parashikuar një ndërhyrje më të gjere ku parashikohet krijimi i parkut në lagje e Re dhe ndërtimi i fushave të basketbollit dhe volejbollit (Zona A). Gjatë vitit 2026 prioritet për Bashkinë Patos është zbatimi i këtij projekti dhe nga studimi ka rezultuar që vlera është më e lart sesa vlera që ne kemi parashikuar gjatë vitit 2025 dhe vlera e nevojshme është 15,736,060 (pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë) lekë.

Pra në total granti i përfutur i performancës që i shtohet buxhetit për vitin 2026 është 8,843,866.21 (tetë milion e tetëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e një) lekë me tvsh, të ndarë si:

1. 3,955,056 (tre milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e gjashtë) lekë nga granti i brendshëm nga Pushteti qendror
2. 4,888,810 (katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dhjetë pikë) lekë me tvsh nga granti i huaj.

Përdorimi:

Shtohet vlera prej 5,162,031 (pesë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tridhjetë e një) lekë në zërin buxhetor “Krijimi i parkut rekreativ në lagjen e Re (ku përfshihet ndërtimi i fushave të basketbollit)”. Dhe është parashikuar që vlera prej 3,681,835 (tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë në zërin buxhetor “Studim, projektim dhe hartim i PDV-ve”. Dua të theksoj që hartimi i PDV-ve do jetë për vitin e ardhshëm pasi kërkon një kohë më të gjatë studimi dhe bëhet nga ekspert të jashtëm

Kërkojmë këshillit të bashkisë Patos:

1. Të miratojë shtesë buxheti për vitin 2026 nga fondi “Granti me bazë performance” në vlerën 8,843,866. lekë, të ndara si i citova më sipër
2. Të miratojë përdorimin e grantit me bazë performance për:
  - a. Shtesë fondi në projektin “Krijimi i parkut rekreativ në vlerën 5,162,031 (pesë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tridhjetë e një) lek;
  - b. Shtesë fondi në zërin buxhetor “Studim, projektim dhe hartim i PDV-ve”, në vlerën 3 milion e 681 mijë .

Lori Musaj - Gjatë mbledhjes së komisionit kemi diskutuar mbi këtë projektvendim të cilin si komision kemi konstatuar se përmbajtja e projektvendimit është në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar pa asnjë ndryshim me tre vota pro.

Armand Ahmetaj - Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e shtatë 7-Projekt-vendim “Mbi përdorimin e grantit me bazë performance e fituar për vitin 2025 dhe shtim buxheti për vitin 2026”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord ?

Miratohet me 14vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE


Refaela Xeba



Smerolë Hoxhë  
Artan Velami  
Lori Musaj  
Adile Alushaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2147 Prot.  
13

Patos më 03 02.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.01.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2026, nga fondet e trashëguara nga viti 2025".

Mimoza Shëmbari- Referuar projektvendimit që kemi paraqitur shoqëruar me relacionin dhe tabelat financiare shoqëruar projektvendimit kemi përgatitur projektvendimin dhe kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi për shtesë buxhetit për vitin 2026, nga fondet e trashëguara nga viti 2025. Nga rakordimet paraprake që kemi bërë me degën e thesarit dhe me analizën e buxhetit faktik 2025 kemi fonde që trashëgohen për vitin 2026 në vlerën 134 milion e 222 mijë e cila vjen të ardhura të trashëguara të mbetura të papërdorura 42,435,655 lekë. Me aktin normativ nr. 11 datë 19. 12 kemi marrë një shtesë transferte në fund të vitit e cila ka mbetur e pa shpërndarë në planet e buxhetit për vitin 2025 dhe vjen si shtesë buxheti 2025 por që i shtohet buxhetit të 2026 me vlerë 5 milion e 41 mijë. Kemi një transfertë të pakushtëzuar të trashëguar e papërdorur për vitin 2025 me 58,453,909 lekë dhe një transfertë specifike e trashëguar me vlerë 28,290,598 lekë. Referuar burimit shtesë nga fondet e trashëguara 134 milion e 222 mijë lekë kemi dhe shpërndarjen e tyre për mbulimin e shpenzimeve si më poshtë.

Shpenzime/korrente angazhime të 2025 që i përkasin faturave që janë të palikujduara për dhjetorin 2025 vlerën 2,028,159 lekë. Siç thash dhe pak më lart shtesën e transfertës të pakushtëzuar 5 milion 041 mijë lekë e kemi kanalizuar dhe shpërndarë për të mbuluar shpenzime korrente që i përkasin shpenzimeve të personelit për të mbuluar koston e shërbimeve të personelit që vjen nga rritja e pagës minimale.

Shpenzime kapitale vazhdojnë, financimi i angazhimeve të 2025, 113 milion 526, referuar dhe tabelës shoqëruese për investime dhe investime kapitale të reja që i shtohen buxhetit 26 në vlerën 13 milion 625 mijë lekë.

Burimet shpenzimet e balancuara me 134,222

Investimet shtese janë parashikuar 4 milion lekë do ti shtohet financimit të blerjes së skrepit për pastrimin e kanaleve kulluese dhe vaditëse të cilat vijnë nga trashëgimi i fondeve brenda këtij funksioni të cilat nuk përdoren në funksione të tjera. Është miratuar në buxhetin e vitit 2026 1 milion lekë dhe i shtohet vlera 4 milion lekë. Është shtesë financimi. Kemi parashikuar fondin që vjen i papërdorur në funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit 3 milion e 330 mijë lekë për rikonstruksionin e zyrave të MZSH. Kemi planifikuar, kemi shpërndarë për tu shpenzuar vlere që vjen nga tarifa e papërdorur për menaxhimin e mbetjeve me vlerë 6 milion 295 për blerje kontinierë të cilat këto nuk mund ti përdorim në asnjë funksion tjetër por i shtojmë këtij funksioni për vitin 2026 dhe vlerën që kishim parashikuar për blerje kontenierësh për këtë funksion nga burimet e tona e kemi shpërndarë për të mbuluar shpenzimet gjyqësore për vitin 2026.

Shoqeruar projektvendimit janë tabelat ku janë edhe struktura buxhetore si dhe produkte për çdo program.

Lori Musaj- Gjatë mbledhjes së komisionit kemi diskutuar dhe mbi këtë projektvendim të cilin si komision kemi konstatuar se përmbajtja e projektvendimit është në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi votuar pa asnjë ndryshim me tre vota pro.


Armand Ahmetaj - Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë Projekt-vendim "Për miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2026, nga fondet e trashëguara nga viti 2025".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Artan Velgami

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Lori Musaj

Aolite Alushaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 216 Prot.

Patos më 03 02.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.01.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për disa ndryshime në vendimin nr. 77, datë 27.11.2025, “Për miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Patos dhe Ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026”.

Juela Shpata- sot paraqesim Projektvendimi nr. 05 datë 19.01.2026 Për disa ndryshime në vendimin nr. 77, datë 27.11.2025, Për miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Patos dhe Ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026. Ky projektvendim vjen si pasojë e ndryshimit të nivelit të pagës minimale V.K.M-së nr. 776, datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Për bashkinë Patos dhe ndërmarrjet në varesi në total përfitojnë 144 punonjës të cilët janë të ndarë dhe më poshtë, gjithashtu kërkojmë të ndryshojmë dhe pagën e sekretarit të këshillit bashkiak e cila njëhësohet me pagën e drejtorave të bashkisë në vlerën 140,000 një qind e dyzet mijë lekë të reja

Lori Musaj – Në mbledhjen e komisionit kemi diskutuar mbi këtë projektvendim i cili është shumë i rëndësishëm pasi synon të përmirësoj kushtet ekonomike të punonjësve reflektorialitetin e rritjes së kostove të jetës. Rritja e pagës minimale përfaqëson një hap konkret drejt mbështetjes së të ardhurave më të ulta dhe rritjes së dinjitetit të punës. Komisioni e ka shqyrtuar këtë projektvendim të cilin e konsideron me ndikim pozitiv social. Ne e kemi votuar me 3 vota pro.

Armand Ahmetaj – kemi ndonjë diskutim?

Atëherë propozoi ta kalojmë në votim pikën e nëntë Projekt-vendim “Për disa ndryshime në vendimin nr. 77, datë 27.11.2025, “Për miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Patos dhe Ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 14 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Smerod Hoxha  
Artan Velceu  
Lori Musaj  
Aolite Alushaj

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 210/Prot.  
1

Patos më 03 02.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 30.01.2026 në orën 14:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Raport për dëgjuesat publike për vitin 2025.

Armand Ahmetaj Ketë material e keni dhe në email.

Armand Ahmetaj – Mbledhja deklarohet e mbyllur!

SEKRETARE

Refaela Xeba

*Smeralda Hoxhi*  
*Artan Velkani*  
*Lori Musaj*  
*Adile Alushaj*

KRYETAR

Armand Ahmetaj